



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale ndërtimi për rehabilitim të akseve rrugore: fshati Grepckë, lagjia “Çuedar” faza II, rruga për te ish parku autobusave, lagjia “Hasan Seitaj”, rruga që lidh lagjet “Cerri-Omeri-Hysenbelliu-Gorçe”, fshati Potom

LLOJI I PROCEDURËS: E HAPUR, E THJESHTUAR

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44100000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 558 419 (dymilion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) lekë PA TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas Shtojcës 8

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros, në

të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.”*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2024 dhe ato të maturuara për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së.

Shënim : Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025 (në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.8).

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e realizimit të procedurës, si më poshtë ose **ekuivalente me to:**

- Çertifikatë ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose **ekuivalent**

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të mallrave duke qenë se këto mallra do të përdoren në objekte arsimore dhe koha e përdorimit të tyre duhet të jetë jo e shkurtër. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Shënim: Çertifikatat e mësipërme/ekuivalente duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të çertifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të

operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata në perputhje me shërbimet/mallrat që ka marrë përsipër në marreveshjen e bashkëpunimit.

2.3.3 Kërkesat e garancisë

Deklaratë nga Operatori Ekonomik që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në çdo kohë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në sasinë dhe cilësinë e këkuar.

Shënim : Mos dorëzimi i deklaratës përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon që OE fitues të japi garanci për mallrat të cilat do të jenë objekt i prokurimit duke qenë se edhe objekti i është i një rëndësie të veçantë. Gjithashtu AK kërkon që OE të sigurojë transportin pasi AK nuk mund t’a kryejë atë, pasi nuk disponon mjetet dhe stafin e posaçëm. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

2.3.4 Mjetet e transportit

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet si më mëposhtme:

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

Për të dëshmuar këtë, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nese janë në pronësi, duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik, policen e sigurimit vjetor të vlefshme gjatë zbatimit të kontratës)
- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik, nese janë me qera, duhet të paraqiten dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, kontrata noteriale e qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, regjistrimi i mjetit (leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor të vlefshme gjatë zbatimit të kontratës)

Për plotësimin e kriterit të mësipërm të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari permbledhës i vetedeklarimit).

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 1, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjën “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Disponimi i këtij mjeti tregon se Operatorët Ekonomik kanë aftësitë e duhura për të kryer transportin e materialeve të Ndërtimit. Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të siguruar realizimin e kontratës në mënyrë efikase dhe të sigurt duke marrë parasysh volumet e mallrave që duhet të transportohen. Mjeti i transportit me kapacitet mbi 10 ton është një element i rëndësishëm për realizimin e kontratës. Ky lloj mjeti është i nevojshëm për të transportuar materialet e ndërtimit në sasinë dhe kohën e duhur.

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet Teknike

Objekti i prokurimit: **Blerje materiale ndërtimi për rehabilitim të akseve rrugore: fshati Grepckë, lagjia “Çuedar” faza II, rruga për te ish parku autobusave, lagjia “Hasan Seitaj”, rruga që lidh lagjet “Cerri-Omeri-Hysenbelliu-Gorçe”, fshati Potom, shoqërohet me preventiv dhe grafikun e punimeve të hartuar nga Drejtoria e Planifikim Territorit, Bashkia**

Skrapar, ku në të përcaktohet fondi limit i procedurës së prokurimit, specifikimet teknike, si dhe sasia e mallrave të kërkuara.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka miratuar preventivin dhe është në fazën e prokurimit.

Për pasojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Specifikimet teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte te Tenderit, për procedurën tip “E Hapur, E Thjeshtuar”, Mallra.

Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte te Tenderit, për procedurën “E Hapur, E Thjeshtuar”, “Mallra”, me objekt prokurimi **“Blerje materiale ndërtimi për rehabilitim të akseve rrugore: fshati Grepckë, lagjia “Çuedar” faza II, rruga për te ish parku autobusave, lagjia “Hasan Seitaj”, rruga që lidh lagjet “Cerri-Omeri-Hysenbelliu-Gorçe”, fshati Potom”**. Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Benis Dosti

Florand Osmani